



Prishtinë: 24.03.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_239\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_360\_03\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_360\_02\_10** ;
5. Apelimi i e konsumatorit me datë 22.03.2010; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit Rrahim Sylja (shifra e konsumatorit DPR - 207123) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 01.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.11.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Në muajin 12/2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nga ai mekanik në atë elektronik, ku kanë hequr nga matja njehsori elektrik nr. 17720456 dhe kanë vendosur për matje të konsumit njehsori elektrik me nr. 40861348.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 2265

- Me datë 07.02.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17720456, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të falsifikuara, njehsori elektrik është i prodhimit 2001 kurse vulat shtetërore i ka të vitit 1990. Njehsori elektrik është frenuar mekanikisht dhe se njehsori ka regjistruar energjinë elektrike me pak se sa duhet, numëruesi i njehsorit është i manipuluar, i kthyer mbrapa, ka gjurmë të gërvishtjes dhe të kthimit mbrapa të numëruesit.

**Provë:** Procesverbali me nr. 03/07 të datës 07.02.2008

- Me date 31.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e njehsorit elektrik kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk është brenda kufijve të lejuar të matjes së energjisë elektrike.

**Provë:** Protokoli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 02/1645 datë 31.03.2008

- Me datë 30.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverballi i KEK-ut nr. 0143457 të datës 30.05.2008
- Me datë 05.06.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP05938 në vlerë prej 1,152.44 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP05938 e datës 05.06.2008
- Me datë 16.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.11.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 30.11.2009
- Me datë 01.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 05.03.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë një vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.  
**Provë:** Vendimi i DMK së ZRRE-së i datës 05.03.2010
- Me date 22.03.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_360\_03\_10 .  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 22.03.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_360\_03\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së, por që duhet të bëhet rilloaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar. Sipas protokollit mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik njehsori elektrik nuk është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se mesatarja e kufirit të gabimit të matjes së energjisë elektrike për këtë njehsor është -30.74 %, andaj duhet që KEK-u të kthehet mbrapa për një vit (periudha 01/2007 – 12/02007) dhe se për energjinë e faturuar për atë periudhë të shton edhe 30 % për secilën faturë.

Bordi i ZRRE-së pasi ka analizuar të gjithë dokumentacionin ka vendosur ta **refuzojë pjesërisht** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar